

MË E BUKURA VAJZË E SHKOLLËS

tregim

nga

Enkelejd Lamaj

Epo, mirë. Tani do të të tregoj gjithçka që ka ndodhur e do të them edhe përse të kam thirrur. Ti vetëm dëgjo e mos më ndërprit. E mos u shqetëso, se do të të tregoj gjithçka, fije e për pe. Nëse ke ndonjë pyetje, ma bëj në fund kur të kem mbaruar. Mirë?

Mirë pra. Ah, kam ndezur edhe... këtë regjistruetin, sepse dua të regjistroj gjithçka që do të them, nuk besoj se ke ndonjë kundërshtim, apo ke? Jo? Shumë mirë atëherë. Fillojmë, ose më mirë të them, *unë* po filloj.

Gjithçka filloi ditën që mësuese Tefta i prezantoi klasës nxënësin e ri. Unë mungoja, atë ditë, për arsyeje shëndetësore, por mbasdite, Fatosi erdhi me një frymë e më tregoi gjithçka që nxënësi i ri kishte bërë qysh prej orës së parë e deri në atë të fundit.

Por më shumë se për këtë, shoku im më i ngushtë, kish rendur që të më tregonte për vetullën e tij. Vetullën e *majtë* të tij.

Të nesërmen unë u ktheva në shkollë dhe e pashë vetë nxënësin e ri ulur në bankën e dytë nga ana e derës dhe gjithçka që ai bëri deri në fund të mësimit.

E natyrisht, pashë edhe vetullën e tij. Vetullën e *majtë* të tij.

Ditën tjetër, nxënësi i ri bëri atë që kishte bërë edhe dy ditët e mëparshme, plus një gjë të re: filloi të shikonte edhe nga banka ime. Të nesërmen e asaj dite, i porsaardhuri në klasën tonë më priste, gjoja rastësisht, tek lulishtja nga ku kaloja çdo mëngjes për të shkuar në shkollë.

Ishte e premte atë ditë dhe unë, si gjithmonë, isha me Tosin e, si çdo mëngjes, dhjetë minuta përpara se të fillonte ora e parë.

«Mirëmëngjes çuna!» dëgjuam të na përshëndesnin nga pas dhe ndalëm hapat.

«Oh, Emin», ia bëri Tosi. «Mirëmëngjes!»

E përshëndeta edhe unë.

«Ti je Gazmendi», tha Emini, ndërsa filluam të ecnim ngadalë. «Edi më tha se je në skuadrën e futbollit. E di?... edhe unë jam aty, por do të filloj javën tjetër.»

«Gazi është më i miri i ekipit, e dije?» ia priti Tosi.

«E di dhe e kam parë një herë. Kur erdhët në Tiranë dhe luajtët me ata të ‘Naim Frashërit’...»

«Uuuh! E mbaj mend. Atë ditë Gazi bëri tre gola.» Pastaj Tosi u ra shpatullave të mia. «E mban mend?»

Unë pohova me kokë. E mbaja mend posi, ajo kishte qenë një nga ndeshjet më të bukura, por ato çaste mendoja tjetër gjë.

Emini tha: «Dhe unë prandaj doja të njiheshim. Jemi edhe në një klasë tani, apo jo?»

«Ti s’erdhe të njiheshe me mua për këtë gjë», ia prita dhe me bisht të syrit pashë Tosin të ulte sytë përtokë.

Edhe Emini, nga ana e vet, uli kokën. Ndoshta nuk e priste që unë t’ia thosha në atë mënyrë.

«Ti doje të më njihje për tjetër gjë, apo jo?» vazhdova.

Emini heshti dhe vetëm pasi bëmë disa hapa të mira foli.

Tha: «Po, ke të drejtë. A mund të flasim vetëm për vetëm?»

«Fatosi është shoku im më i ngushtë, më shumë se një vëlla, prandaj ç’ke për të thënë, thuaje», ia ktheva, duke parë nga shoku im.

Emini ngurroi. Atëherë ndërhyri Tosi: «Çfarëdo që të jetë, Gazi do të ma thotë që do të ma thotë, prandaj thuaje. Le që ai ta tha vetë, e dimë shumë mirë se për çfarë do të flasësh.»

«V-vërtet?» arriti të belbëzonte Emini.

«Po vërtet», ia ktheva unë. «Xhilda.»

Dëgjimi i atij emri gozhdoi këmbët e Eminit. Ndoshta një pjesë e tij vazhdonte të mos besonte se unë e Tosi e dinim me të vërtetë arsyen e atij takimi mëngjesor.

«E nga e dini?»

«Eh, or mik», tha Tosi, duke hapur krahët në një gjest të tipit s’do-dhe-aq-shumë-mend. «Që momentin që kapërceve pragun e klasës sonë, nuk arrin të shqitësh sytë prej bankës së fundit të rreshtit tonë.»

«Obobo, çfarë figure! Do e këtë marrë vesh gjithë klasa.»

«Kjo është e vërtetë», ia prita unë, «por s’ke pse shqetësohesh. Asnjë njeri nuk i fut hundët kur në mes është Xhilda.»

«Përveç teje.»

«Jo», ia ktheva. «As unë nuk i fus hundët në punët e Xhildës.»

Emini më pa i habitur. «Po ti je vëllai i saj.»

«E di, por kjo s'është aspak e rëndësishme.»

Emini u mendua për disa çaste, pastaj hapi gojën dhe tha: «E çfarë duhet të bëj unë atëherë?»

«Në ç'kupim?» ia ktheva unë, që gjithsesi e kisha kuptuar shumë mirë se çfarë donte të thoshte.

«Po ja, unë doja të flisja me ty, sepse... sepse ti je vëllai i saj... binjak dhe... dhe... ti... ti, domethënë ajo...» Emini filloi të lëvizte duart i dëshpëruar, duke mos ditur si të vazhdonte më tej.

Ndërkohë arritëm tek muri rrethues i shkollës dhe ndaluam.

«Dëgjo», ndërhyri Tosi, «në qoftë se mendon të fitosh simpatinë e Xhildës dhe mendon se Gazi do të të krijojë telashe, harroje.»

«Por», vazhdova unë, «unë, si vëllai i vetëm i saj, të këshilloj – dhe të këshilloj thjesht si shok klase, pa asnjë nënkuptim tjetër - që të heqësh dorë.»

«Po ajo është kaq e bukur!» i shpëtoi Eminin me zë të ulët, si i zënë në faj.

«Dhe është pikërisht ky problemi, or mik», tha Tosi.

«Ajo nuk është për ty», thashë dhe, pasi vështrova edhe një herë vetullën e tij, nxitova të korrigjoja veten: «Ose më mirë të thuash se *ti* nuk je për atë.» Isha duke rrezikuar, e dija, por ato momente nuk besoja se Emini do të tërhiqej.

Nga ana e tij, Emini dukej sikur nuk i dëgjoi aspak ato që i thashë. Kishte ngritur kokën dhe shikonte në drejtim të stolave të hekurt. «Është kaq e bukur!» pëshpëriti sërish.

Ktheva kokën nga stolat dhe pashë Xhildën që shfletonte një fletore. Era e lehtë i hidhte flokët e gjatë mbas shpine. «Po», thashë ngadalë. «Më e bukura vajzë e shkollës është.»

Edhe atë ditë, gjatë gjithë orëve të mësimin, Emini vazhdoi të bënte çfarë kishte bërë edhe ditët e mëparshme, domethënë, të kthente vazhdimisht kokën mbas për të parë në bankën e fundit të rreshtit nga dritarja (rreshtit tim). Ishte e pamundur të bënte gjë tjetër. Gjatë pushimeve midis orëve, nuk u përpoq aspak të shkëmbente ndonjë fjalë me mua dhe unë nuk bëra asgjë më pak se ai në lidhje me këtë gjë.

Por mbas mësimin, ishte Fatosi ai që kishte diçka për të më thënë, që sidoqoftë, priti derisa hymë në territorin e lagjes sonë.

«Unë mendoj se duhet t'ia kishe thënë», ishte çfarë më tha me të hyrë në rrugicën tonë.

«Ah!» ia bëra unë. «Ti e di se si e mendoj unë.»

«Po e di. Por ta dish se e ke gabim. Ka një jetë të tërë që mundohem të të mbush mendjen.»

Unë ndala hapat. «Tosi», thashë i vendosur, «Xhilda është motra ime. Motra ime *binjake*. Do ta kisha kuptuar. Dreqi e marrtë, fle një dhomë ngjitur me të.»

«Ti s'ke për ta kuptuar kurrë, Gazi dhe e di përse? Sepse nuk *do* që ta kuptosh.»

«Ohu edhe ti!»

«Jo, nuk ka 'ohu edhe ti!', Gazi. Duhet t'i thërrasësh mendjes vëlla i dashur. Gjithë ato që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve, duhet ta kishe kuptuar me kohë. Tani që erdhi ky... mund të përsëritet përsëri.»

«Asgjë nuk dimë se çfarë ka ndodhur gjithë këto vite, Tosi. Me përjashtim të muhabetit të qenit, që hajt se mund të thuash se *dimë* diçka, megjithëse ta kam thënë e po ta them përsëri për të miliontën herë, atë ditë motrës sime i kishte hipur në kokë të tallej me mua.»

«Po pse thua kështu hë? Po... po babai yt? Po ajo që gjeta në kosh, apo e harrove?»

«Babi vdiq për faj të mjekëve dhe ta kam thënë edhe një herë tjetër dhe ajo që gjete në koshin e plehrave, nuk do të thotë asgjë. E nëse tani do të më përmendësh edhe tezen, ta ripërsëris që ishte thjesht një aksident, okej? Sidoqoftë, nuk e kuptoj se ç'hyn kjo këtu me Eminin.»

«Si ç'hyn? A nuk ia pe vetullën?»

Ia kisha parë dhe ia kisha parë shumë më mirë nga ç' duhej. Por Tosi kishte parë edhe reagimin e Xhildës, atë ditë të parë që unë mungoja. Prandaj dhe kishte frikë.

Ndërkohë kishim arritur tek hyrja e pallatit tim dhe unë përfitova nga rasti të shkëputesha nga ai muhabet.

«Dëgjo», i thashë. «Takohe mi nesër dhe flasim, mirë? Unë ndërkohë do mundohem të marr vesh se çfarë mendon Xhilda.»

«Mirë, si të duash. Por dëgjo, po deshe... po qe e nevojshme, mund edhe të përdorim gjëra të tjera për ta larguar. Eminin e kam fjalën.»

Mohova me kokë. «E di shumë mirë që nuk ka për të funksionuar.»

«Beh, se e provon, nuk është keq.»

«Flasim nesër», i thashë dhe ngjita shkallët.

Mbasditen e kalova mbi libra. Në kuptimin e thjeshtë të fjalës, sepse nuk arrita të lexoj as edhe një rresht të vetëm. Në realitet u gjenda duke menduar se si kishte nisur gjithçka. Dhe gjithçka kishte nisur si shaka. Të paktën kjo ishte fjala që qarkullonte në shtëpinë tonë, deri një vit përpara vdekjes së babait.

Ajo që e nisi ishte teze Flora, e cila atë kohë jetonte në Amerikë.

«E dini?» thoshte gjithmonë teze Flora sa herë që vinte në Shqipëri (sa herë që ajo vinte në Shqipëri, pjesën më të madhe të kohës e kalonte në shtëpinë tonë). «Dita kur kanë lindur binjakët, është dita e shtrigave. Motra ime e madhe ka lindur një shtrigë.»

As tani nuk arrij ta kuptoj se përse teze Flora *zgjodhi* të pagëzonte Xhildën shtrigë dhe jo mua shtrig, megjithatë, kjo është çfarë ajo thoshte gjithmonë dhe asnjë nuk mori mundimin t'i kujtonte se unë kisha lindur vetëm tetë minuta mbas Xhildës. Tek e fundit ishte thjesht një shaka.

Por një herë, dy herë, dhjetë herë... motra ime filloi ta merrte seriozisht. Ishim vetëm pesë vjeç, atëherë, akoma flinim në të njëjtën dhomë dhe shpeshherë unë e dëgjoja të qante natën dhe kur e pyesja se çfarë kishte, më përgjigjej: «Unë jam me të vërtetë një shtrigë.»

Natyrisht unë mundohesha ta bindja se nuk ishte e vërtetë dhe se teze Flora bënte thjesht shaka, por asaj nuk i mbushej mendja.

Një vit më vonë, teze Flora solli një dhuratë speciale për Xhildën, me të cilën hapi dyert e ferrit. Një kostum shtrige. As fshesën nuk kishte harruar. Por kishte harruar reagimin e kunatit të vet.

Dhe kunati i saj, alias babai im, alias babai i Xhildës, nuk e pëlqeu aspak atë dhuratë, megjithatë duroi e nuk tha gjë e u soll normal deri në çastin që përcolli teze Florën në Rinas. Me t'u kthyer në shtëpi, babi, hyri drejt e në dhomën tonë. Xhilda kishte veshur kostumin dhe, pasi kishte trukuar sytë e buzët me bojë të zezë, vinte vërdallë dhomës me bishtin e fshesës midis këmbëve, ndërkohë që unë e sodisja prej krevatit tim.

Nuk e bëri të gjatë babi im, nuk tha as edhe një gjysmë fjale. Vrapoi drejt Xhildës, i rrëmbeu fshesën dhe e qëlloi me aq fuqi saqë fshesa u thye në dysh në kurrizin e saj dhe Xhilda u shtri sa gjatë e gjerë mbi tapet. Nuk pata kohë as të kuptoja se çfarë po ndodhte se babi ngriti Xhildën në ajër prej flokësh dhe i shqeu kostumin prej trupit. Pastaj e mblodhi shuk dhe duke dalë prej dhomës tha: «Nuk do të lejoj që vajza ime të bëhet me të vërtetë një shtrigë, dëgjove? Ta këpus kokën si të zogut, vetëm provoje po ta mbajti.»

Unë e dëgjoja, sepse isha ende i tëri, atje sipër krevatit tim, por Xhilda dergjej në mes të dhomës, e mbledhur kruspull, vetëm me kanotiere e mbathje dhe tani qante, tani bërtiste, tani ulërinte.

Kjo ishte dita e parë e luftës midis babit dhe Xhildës.

Mbas asaj dite unë u ktheva në fëmijën e preferuar të tij, në kuptimin e plotë të fjalës, kurse Xhilda, në skllaven e tij. Më kot u mundua mami të bënte diçka. Sipas babit, mami kishte fajin kryesor (tek e fundit Flora ishte motra e saj, apo jo?) ndaj dhe duhet të paguante edhe ajo.

E babi filloi të pinte. Edhe ato pak herë që kthehej në shtëpi esëll, merrte shishen e konjakut prej bufesë dhe pinte derisa mezi e mbanin këmbët.

Një mbrëmje, mbasi kishte tharë një shishe të tërë Skënderbeu, babi erdhi në dhomën tonë. Mua më përzuri (edhe pse i dehur mua më fliste gjithmonë me tone të buta), më tha të dilja në kuzhinë e të luaja me ndonjë gjë, a thjesht të bëja çfarë të doja, sepse ai kishte pak punë aty, me Xhildën. E ndërkohë, duart e tij hiqnin rripin prej pantallonave.

Atë ditë shkova me të vërtetë në kuzhinë. Disa ditë më vonë, babi erdhi sërish në dhomë e më tha të shkoja të merresha me ndonjë gjë, por atë herë unë qëndrova në korridor dhe dëgjova vërshtëllimën e rripit në ajër e të bërtiturat e Xhildës, derisa mami erdhi dhe, me lot ndër sy, më tërhoqi mënjanë.

Disa ditë më vonë, Xhilda siguroi plastelinën e saj.

Ia sigurova unë, për të qenë më të saktë. Xhilda mu lut me lot ndër sy, një natë, mbasi babi i kishte bërë vizitën e radhës, dhe unë, që vuaja po aq sa ajo, vendosa t'ia blija. Tre pako të tëra me plastelinë i bleva.

Një javë më pas, babai zuri krevatin. Doktor i që erdhi ta vizitonte foli për diçka si amputacion të gishtit të madh të këmbës së djathtë, që babi im nuk pranoi. Atëherë doktori i dha çfarë i dha, por sëmundja shkonte gjithnjë duke u rënduar dhe, mbas disa ditësh, kur doktori erdhi ta vizitonte sërish, i dha si të vetmen zgjidhje, ndërhyrjen kirurgjikale. Disa ditë më vonë babai u shtrua në spital.

Kur u kthye që andej, me gishtin e këmbës të prerë, filloi të mallkonte Xhildën. Sipas tij, ishte ajo shkaktarja dhe megjithëse nuk ishte ende në gjendje të ecte, arriti gjithsesi të vinte duart mbi motrën time, e cila doli me një sy të nxirë e një krah të ndrydhur.

Tre ditë më pas, babai u bë sërish rëndë. Sëmundja, e cila normalisht duhet të ishte zhdukur, filloi të përparonte përsëri. Çdo orë që kalonte, atij i shtoheshin dhimbjet dhe çdo orë që kalonte thërriste Xhildën dhe i betohej se kur të ngrihej do ta vriste.

Por Xhilda nuk bënte asgjë të keqe. Ajo thjesht luante me plastelinën e saj. Nuk bënte asnjë lloj magjie. Ajo nuk ishte aspak një shtrigë. Unë mund të vijja dorën në zjarr për këtë.

Teze Flora mori në telefon dhe pyeti për shëndetin e kunatit të vet, por ajo nuk dinte asgjë në lidhje me situatën në shtëpinë tonë. U interesua edhe për shtrigën e vogël dhe u tha se shtriga e vogël ishte me të vërtetë e atillë. Natyrisht, një shaka, të cilën, teze Flora e pëlqeu shumë.

Tre ditë përpara ditëlindjes sonë, babait i prenë këmbën e djathtë. Të nesërmen e asaj ditë, Fatosi, gjeti pranë koshit të plehrave një copë plasteline, e cila kishte formën e një këmbe të vogël, tamam si ato të kukullave.

Një këmbe të vogël, së cilës i mungonte gishti i madh.

Ditën kur unë e Xhilda mbushnim shtatë vjeç, babai vdiq nga një hemorragji e brendshme, të cilën, asnjë mjek nuk mori përsipër ta shpjegonte.

Që nga ajo ditë, unë nuk e pashë më Xhildën të luante me plastelinën e saj... deri ditën kur qeni i Islamit më kafshoi në këmbë.

Kjo ndodhi rreth dy vjet më pas. Të gjithë u habitëm: Roza mbahej si një prej qenve më të urtë të lagjes. Nuk bënte asgjë tjetër vetëm rrinte ulur përpara derës së shtëpisë së Islamit, apo poshtë hijes së ndonjë prej pemëve që zbukuronin rrugën dhe luante bishtin. Por kohët e fundit nuk e di pse sa herë që unë kaloja pranë, ajo ngrihej prej vendit dhe largohej. Fatosi dhe të gjithë fëmijët e tjerë të lagjes mund t'i afroreshin e ta përkëdhelnin, kurse unë jo më. Kjo gjë filloi gradualisht, prandaj tani nuk jam në gjendje të kujtoj me saktësi se kur nisi, por mund të them se diku aty rrotull vdekjes së babit tim. Në fillim thjesht më largohej, madje edhe kur përpiqesha t'i jepja ndonjë gjë për të ngrënë, Roza largohej dhe vetëm kur unë braktisja ushqimin dhe largohesha, ajo afrohej që të hante.

Por, ajo që bënte Roza sa herë që Xhilda i kalonte pranë, ishte akoma edhe më e çuditshme. Jo vetëm që largohej, por largohej me shalë nëpër këmbë e duke lehur. Dhe në ato raste, nuk kthehej më në vendin e mëparshëm. Thjesht ikte dhe gjente një vend tjetër për të pushuar, mundësisht në anën tjetër të rrugës, ose brenda oborrit të shtëpisë së të zotit.

Atje ishte edhe ditën që m'u vërsul. Xhilda kishte kaluar vetëm pak minuta përpara meje. Kur unë e Fatosi iu afruam gardhit me kallama, Roza lehte me të madhe. Nuk e kisha dëgjuar kurrë më parë të lehte ashtu. Në shtëpinë e Islamit nuk duhet të kishte pasur njeri, se me siguri dikush do të kishte dalë: Roza po bënte namin.

Fatosi iu afrua gardhit. «Se mos u ka hyrë ndonjë në shtëpi, ore», më tha.

Gjëja e parë që më kaloi në mendje ishte të lajmëronim dikë dhe ia komunikova këtë gjë edhe shokut tim.

«Po sikur ai të ikë ndërkohë?» ma ktheu ai.

Atëherë mbetej vetëm një gjë për të bërë. Duhet të provonim të shikonim brenda.

«Ndoshta është më mirë që ti të rrish përjashta», më tha Fatosi. «Kohët e fundit sikur të ka marrë inat.»

«Po unë s'i kam bërë asgjë, dreqit.»

Fatosi ngriti supet dhe në atë çast Roza doli jashtë gardhit. Doli përpara nesh dhe filloi të lehte me dhëmbët përjashta, prej të cilëve i kullonin sekrecione të bardha.

«Unë them se është më mirë ta lëmë fare», thashë.

«Ke të drejtë», ma ktheu Fatosi. «Sot qenka tërbuar fare.»

Dhe dukej me të vërtetë e tërbuar. Por problemi qëndronte gjetkë. Roza nuk më shqiste, as edhe një çast të vetëm, sytë e saj të mëdhenj. Nuk kishte as edhe një dyshim: e kishte me mua. Çfarëdo që të kishte, e kishte me mua.

Edhe Fatosi e kuptoi. «Mos u mundo të vraposh», më tha. «Thonë se të ndjek akoma edhe më keq, po vrapove.»

Por unë s'kisha aspak ndër mend të vrapoja... derisa Roza m'u vërsul si shigjetë.

Lëshova çantën përtokë, thirra gjithë forcën time motorrike dhe vrapova drejt hyrjes së pallatit, duke thirrur me gjithë oktavët e mundëshëm të zërit. Disa hapa përpara se të arrija shkallën e parë të pallatit, ndjeva thembrën e Akilit të pësonte një takim të tipit të tretë me një tufë thikash të mprehta. U rrëzova sakaq dhe koka sfidoi shkallën e parë në fortësi, sfidë që, natyrisht, e humbi. Se çfarë ndodhi më tej, nuk e mbaj mend mirë, por mbaj mend se dëgjova zërin e mamasë sime dhe pastaj atë të një burri që bënin garë se kush bërtiste më shumë. Përfundimi: unë fashova këmbën, bëra vaksinën e tetanozit dhe vura pesë kapëse në kokë.

Të nesërmen në drekë, motra ime hyri në dhomë me tre kuti të reja plasteline e një copë shkumësi të kuq. Mu a afrua ngadalë dhe u ul pranë meje.

«Të dhemb?» më pyeti, duke më kilikosur mbi fasha.

«Pak», ia ktheva.

Xhilda u mjaftua me një shikim në sytë e mi. Dhe kishte diçka në sytë e saj, diçka që unë e kisha parë edhe më përpara.

«Nuk arrij ta kuptoj përse», belbëzova. «Unë nuk i kam bërë asgjë. Pastaj Roza nuk mbahej si e egër.»

«E në të vërtetë është e tillë», ma ktheu Xhilda.

«Përse thua kështu?»

«Sepse të gjithë ata që kanë një njollë të bardhë mbi sy, janë të egër. Dhe të këqinj.»

Mu desh një çast i shkurtër për të menduar se për çfarë e kishte fjalën. Pastaj e kuptova. Xhilda i referohej tufës me qime të bardha mbi syrin e djathtë të Rozës... dhe... dhe natyrisht, edhe vetullës së majtë të babait.

«Janë të gjithë të egër dhe të këqinj», përsëriti Xhilda dhe kur pa që unë nuk fola, vazhdoi: «Por s'ka gjë, se jam unë këtu tani. E unë do të marr hak për ty, mirë?»

Këtë herë, çasti që mu nevojiti për të menduar ishte i gjatë e, megjithatë, në fund të tij, ende nuk kisha arritur të kuptoja se për çfarë e kishte fjalën motra ima.

«Unë do vras qenin», më ndihmoi Xhilda. «Do më ndihmosh?»

Edhe vetë u habita kur prej gojës sime dëgjova të dilte: «Po.»

Atëherë, Xhilda, hapi plastelinën dhe filloi të luante.

Në fillim bëri një top të madh dhe pastaj filloi ta shtypte nga dy anë, derisa ajo mori formën e një rrote. E vetëm pastaj filloi të punonte me gishta. E unë i qëndrova pranë ndërsa ajo luante tepër e përqendruar e me një shkathtësi që ia kalonte edhe mamit kur punonte me shtiza. Dalëngadalë, pashë se plastelina filloi të merrte formë dhe, po dalëngadalë, unë arrita ta *identifikoja* atë formë. Në fillim i bëri bishtin, të cilit i ngriti

majën përpjetë, pastaj bëri këmbët; së pari ato të përparmet, pastaj ato të pasmet. Por, përpara se të fillonte të punonte me kokën, u kthye nga unë.

«Tani më duhet ndihma jote.»

«Hë.»

«Duhet të ngresh tapetin.»

«Tapetin?»

«Po, më duhet pak vend për të bërë një vizatim.» Dhe më tregoi shkumësin e kuq.

«Po sikur të vijë mami?»

«Mos ki merak, se nuk do të vijë, pastaj edhe po të vijë, ne thjesht po luajmë, apo jo?»

Po, ne thjesht po luanim, por duke bërë vizatime me shkumës mbi pllakat e shtëpisë.

«Por sidoqoftë, mos u tremb se nuk do vijë», tha Xhilda sikur të kishte lexuar mendimet e mia. «Ka shkuar nga teta Sabrija.»

E unë e besova: ndërsa ajo u rikthye të merrej me plastelinën, fillova të ngrija tapetin.

Mbaruam të dy në të njëjtën kohë: unë kisha zbuluar pothuajse të gjitha pllakat e vjetra të dhomës dhe Xhilda kishte mbaruar së gdhenduri qenin prej plasteline.

«Tani, e ka radhën vizatimi», tha dhe pasi la qenin prej plasteline mbi krevatin tim, mori shkumësin dhe u ul në gjunjë.

Në fillim bëri një rreth të madh e pastaj, brenda tij vizatoi një yll me gjashtë cepa, të cilat i lidhi me njëra – tjetrën me vija të drejta. E në fund, brenda yllit me gjashtë cepa, vizatoi edhe një trekëndësh tjetër. Pastaj, mori qenin e u bë gati ta vinte në mes të vizatimit, por ndërroi mendje.

«Uh, harrova», tha dhe u ngrit e shkoi tek komodina e vet. Mori një palë gërshërë dhe mu afrua pranë. «Më duhet një copë e vogël nga fasha jote.»

E pa pritur përgjigje, u ul dhe preu një cep sa gjysma e thoit tim të vogël. Pastaj, mori qenin prej plasteline dhe ia ngjiti copën e fashës disa milimetra mbi syrin e djathtë.

«Për të mos ngatërruar qen», më tha dhe pastaj vuri qenin prej plasteline në mes të vizatimit që kishte bërë. Qëndroi ashtu për disa sekonda dhe pastaj u ngrit, duke i rënë ballit me pëllëmbë. «Sa budallaqe që jam! Kam harruar qirinjtë.»

Doli prej dhomës dhe u kthye në më pak se një minutë, gjatë të cilës mundohesha të kuptoja diçka. Dhe diçka e kuptoja (madje kuptoja më shumë se një thjesht diçka), vetëm se nuk doja ta besoja. Më dukej e pamundur.

Xhilda solli tre qirinj. Se ku i mori një zot e di, por unë nuk e pyeta, ndaj dhe nuk di çfarë t'ju them. I vendosi në cepat e trekëndëshit të vizatuar brenda yllit dhe i ndezi me radhë, me anë të një shkrepëseje që kishte sjellë bashkë me qirinjtë.

Pastaj u kthye nga mua. «Do të rrish?»

Këtë herë nuk u habita aspak kur dëgjova gojën time të thoshte: «Po.»

Xhilda buzëqeshi duke më kujtuar përse ajo mbahej si vajza më e bukur e shkollës. U ula mbas kurrizit të saj dhe prita. Xhilda qëndroi pa lëvizur për disa çaste, pastaj ngriti duart në ajër dhe filloi të thoshte diçka, prej së cilës nuk mora vesh as edhe një gërmë të vetme. Ishte në një gjuhë të huaj, por një gjuhë e huaj që nuk e kisha dëgjuar kurrë më parë. Drita e qirinjve u drodh, por – i thashë vetes – me siguri për shkak të frymës së Xhildës... Xhildës, e cila ato momente, merrte një prej karficave që kishte në kokë dhe e ngulte në kokën e qenit prej plasteline.

E përsëriti atë gjë tre herë, praktikisht derisa në kokën e saj nuk mbeti më as edhe një karficë. Pastaj u ngrit, mori qenin prej plasteline dhe kandelat, më tha të fshija vizatimin e të rregulloja tapetin dhe doli prej dhomës. Nuk më tha që të mos i thosha mamit për çfarë kishim bërë (ose më saktë për çfarë *ajo* kishte bërë), por unë e dija që s'ishte e nevojshme një porosi e atillë dhe ajo po ashtu.

Bëra gjithçka që më tha, por bëra edhe atë që nuk më tha. Atë mbasdite vonë, Fatosi erdhi të interesohej se si shkonte këmba ime dhe unë, pasi u sigurova që asnjë të mos kishte mundësi për të na dëgjuar, i tregova gjithçka.

Kur mbarova, Fatosi kishte mbetur me gojë hapur dhe kur foli, fjalët i dolën me vështirësi për shkak të gojës që i dridhej.

«T-ti po t-tallesh me mua», tha e, një çast më pas, u ngrit në këmbë dhe vuri të dyja duart në kokë.

«Të betohem për kokën e mamit. Ti e di që unë nuk gënjej.»

«Atëherë është e v-vërtetë.»

«Çfarë?»

«Që motra jote është një... një shtrigë.»

«Oh edhe ti.» Fillova të qeshja. «Mos më thuaj se beson tani. Ajo thjesht po luante, nuk po bënte asgjë të...»

«Roza ka ngordhur me të vërtetë.»

«...keqe që të mund të... ëh, si the?»

Fatosi u ul pranë meje dhe më pa drejt e në sy. Dukej i trembur, sikur të ishte duke pritur përgjigjen e ndonjë analize e cila do t'i tregonte nëse kishte apo jo ndonjë sëmundje vdekjeprurëse. «Roza k-ka ngordhur.»

«Po tallesh. Ti je bërë ortake me Xhildën dhe po talleni me mua.»

«Jo, të betohem! Mos gjetsha njeri të gjallë në shtëpi tani që do vete, që nuk të gënjej. Roza nuk është më gjallë. Nuk e di se kur dhe si ngordhi, por kur po vija këtu, dëgjova Klodin dhe Arin të flisnin për një qen të ngordhur. I pyeta e më thanë se kur Islami ishte kthyer prej pune, sot në drekë, kishte gjetur Rozën të ngordhur mu në mes të oborrit.»

Orët që vijuan i kalova në tmerr. Kisha frikë të dilja prej dhomës, kisha frikë të takoja motrën time dhe kur ajo erdhi në dhomë, unë u ktheva në anën tjetër dhe bëra sikur flija gjumë. Në realitet dridhesha prej frikës dhe vetëm natën vonë, ndërsa gjumit i kisha dhënë leje pa afat, arrita të thërrisja logjikën e të bisedoja me të.

Ajo që kishte ndodhur atë mbasdite ishte: a) rastësi dhe në ishte e atillë ishte një prej rastësive më të këqija që kisha hasur ndonjëherë, ose b) Xhilda ishte tallur me mua: tallur në kuptimin ‘bërë shaka’.

Mbas shumë pyetjesh e pak përgjigjesh, arrita në konkluzionin se varianti i dytë ishte më i besueshëm: Xhilda kishte bërë *magjinë* e saj në drekë, xhaxhi Islami kishte gjetur qenin e ngordhur në drekë. Prandaj ishte e pamundur që të kishte ngordhur për shkak të *magjisë* së Xhildës. E vetmja zgjidhje ishte se Xhilda e dinte shumë mirë që qeni kishte ngordhur (me siguri që e kishte dëgjuar ndërsa luante jashtë me ndonjë prej shoqeve të saj) dhe erdhi tek unë për të bërë një shaka, e cila në fund të fundit rezultoi perfekte.

Duke menduar kështu, më zuri gjumi atë natë. Të nesërmen isha dyqind për qind i bindur se përfundimi ku kishim arritur, unë e logjika ime, ishte i padiskutueshëm.

Kështu mendova gjatë gjithë viteve që erdhën më mbas dhe as kur teze Flora bëri aksidentin e saj të dytë, një javë mbasi unë e Xhilda mbushëm njëmbëdhjetë, nuk ndryshova mendim.

Ja përse atë ditë, unë nuk mendoja se duhet t’i kisha thënë gjë Eminit, për të vetmen arsye se nuk kishte asgjë për të thënë: motra ime binjake nuk ishte aspak një shtrigë e nuk u bënte magjira njerëzve (apo kafshëve) me shenjë në vetull.

Pikë.

Fund.

Kështu kaloi fundjava. E hëna erdhi përsëri dhe përsëri, Emini, nga rreshti i dritares, rrinte e rrinte e kthente kokën nga banka e fundit e rreshtit tonë. Vazhdoi kështu edhe të martën, edhe të mërkurën. Të enjten, Xhilda erdhi në dhomën time, ndërsa isha duke bërë detyrat e matematikës dhe më tregoi për dhuratën që i kishte bërë një prej shokëve të klasës.

Një copë letre.

Një poezi.

Po ta lexoj, ashtu kot sa për kuriozitet.

“Beibi”

Trupin tënd të hajdhshëm hëna prapë e kërkon/

Vazhdon të ndryshojë në çdo natë që kalon/

Dhe rrezet e arta të diellit verdhosh/

Bëhen xhelozë për flokët e tu/
 Struken pas reve të errëta pus/
 Të dalin nuk duan, por rrinë atje sus./
 Dhe deti i magjishëm magjinë e ka humbur/
 Në dallgët e syve të tu është shkrirë/
 Dhe anës lumenjve trëndafilat janë vyshkur/
 Gjaku i tyre nga dy buzë është përpirë./
 Kur ti merr fjalimin, përreth, çdo gjë pushon/
 Së pëshpërituri/
 Dhe ty të dëgjon./
 Sirenat ndalin këngën e tyre/
 Dhe engjëjt kërcimin në grup, përmbi yje/
 Buzëqeshja e ëmbël mbi fytyrën kristal/
 Jetë për vetë jetën, vetëtimë mbi një mal/
 Lozonjare e përherëshme, një notë romantike/
 Këngë e pakënduar me nofkë erotike: Beibi.
 E.K.

E.K. qëndronte për Emin Kola, por as unë e as Xhilda nuk bëmë komente.

«Shumë e bukur», komentova, duke i kthyer mbrapsht copëzën e letrës.

Xhilda e palosi dhe e futi në xhepin e pasmë të pantallonave. «Por nuk e ka bërë vetë», tha.

«E nga e di ti?»

«E di.»

Zëri i saj ishte i ftohtë e nuk të linte shteg për asnjë lloj komenti.

Ja ku jemi, mendova unë, gjërat po fillojnë të lëvizin.

Atëherë duhet të flasësh me Eminin, më këshilloi zëri i Fatosit prej kokës sime.

Por unë nuk kisha asgjë për t'i thënë Eminit. Por kisha diçka për t'i thënë motrës sime e ajo gjë qe: «Çfarë ke ndër mend të bësh?»

Xhilda buzëqeshi. «Mos vallë, vëlla i dashur, ke frikë se mos i bëj ndonjë magji?»

Ishte radha ime të buzëqeshja. «Ti s' di të bësh magji.»

«Atë e thua ti.»

Nuk fola.

Xhilda ndaloi së buzëqeshuri. «Ai ka shenjën e keqe, ia ke vënë re?» Dhe mbasi unë pohova me kokë, vazhdoi: «Shpresoj të më lërë rehat.»

Unë ngrita supet dhe bëra vetëm një: «Mah!»

Xhilda u bë gati të dilte prej dhomës, pastaj ndërroi mendje, u kthye sërish nga unë e tha: «Pse nuk i thua ti të më lërë rehat?»

«Unë s’ dal xhiro duke i thënë të tjerëve që motra ime është një shtrigë», ia ktheva. «Për të vetmen arsye që ti *nuk* je e tillë.»

«Po unë s’ po të kërkoj të thuash një gjë të tillë. Po të kërkoj thjesht t’i thuash që të më lërë rehat.»

«Beh, motërza ime e dashur, ti je vajza më e bukur e shkollës, është e natyrshme që të të duan.»

«Nuk dua të duhem nga një njeri me... me...»

Por s’kishte nevojë të vazhdonte më tej: unë e kuptova shumë mirë se çfarë donte të thoshte.

«Nuk mund të harrosh, një herë e përgjithmonë? Pse nuk e provon njëherë?» I thashë ngadalë.

«Nuk dua! Nuk dua ta provoj. NUK DUA!»

Nuk doja ta nevrkosja akoma edhe më shumë, ndaj dhe zgjodha të mos e vazhdoja më diskutimin.

Xhilda qëndroi edhe për disa çaste tek dera, duke më fiksuar me sytë e saj që, sa të bukur ishin, aqURREJTJE çlironin, pastaj tha me zë të ulët: «Është më e fortë se mua, Gazi, është më e fortë se mua.»

Pastaj doli dhe unë nuk arrita të përqendrohesh dot më mbi detyra. Thyesat dhe numrat që kisha përpara syve m’u kthyen në shkarravina e vizatime të pakuptimta. M’u kujtua kukulla prej plasteline dhe këmba e saj pa gishtin e madh e m’u kujtua qeni prej plasteline me copëzën e fashës sime mbi njërin prej syve e m’u kujtua edhe taksia prej plasteline që fluturonte në kanalimbas pallatit.

Edhe teze Flora ishte e keqe, Gazi, prandaj dhe zoti i mori mendtë dhe e rrëzoi mbi hekurin e nxehtë, duke i djegur vetullën e majtë. Që unë ta njihja.

Nuk ishte hera e parë që ato fjalë të Xhildës më jehonin në kokë, por sidoqoftë, nuk mjaftonin për të më bindur.

Të nesërmen, ndërsa shkonim në shkollë, Fatosi më pyeti sërish nëse kisha ndër mend t’i thosha gjë Eminit, apo jo.

Iu përgjigja negativisht.

Në çdo pesëminutësh që vështrimi im ndeshej me atë të Xhildës, sytë e saj më pyesnin: Hë ke ndër mend t’ia thuash, apo jo?

Sytë e mi transmetonin imazhet ‘No comment’, por motra ime nuk ishte vetëm e bukur; ishte edhe inteligjente: aq inteligjente sa të kuptonte fare mirë se unë nuk kisha aspak ndër mend të thosha gjë.

Por, sidoqoftë, nuk ishte aq inteligjente sa të arrinte të kuptonte edhe arsyen përse. E kështu, atë mbadite, Xhilda trokiti sërish në derën e dhomës sime. Pa thënë asnjë fjalë, u ul pranë meje e më dha copëzën e letrës.

E hapa dhe lexova:

*Ti ecën mbi natyrë/
Dhe unë fshehtazi të adhuroj/
Në qiellin e lagur/
Ty rreze dielli të admiroj/
Dëgjoj unë trupin tim/
Mbi notat e një kënge/
Si fëmijë mbi një lodër të prishur/
Të qajë për dashurinë tënde.*

«Është dashuruar keq, djali», thashë.

«Shumë», ma ktheu Xhilda, duke u ngritur e përpara se të dilte prej dhomës, mërmëriti: «Shumë keq.»

Ditën tjetër vendosa të shkëmbeja nja dy falë me Eminin. Duhej ta bëja, që të merrja vesh se çfarë kishte ndër mend të bënte.

«Goxha të lezetshme ato poezitë», i thashë gjatë pushimit të madh. «Por nuk i ke bërë vetë, apo e kam gabim?»

Emini u bë spec i kuq në fytyrë. Ndoshta nuk e kishte pritur që Xhilda të më tregonte poezitë. Por, përveç sikletit, sytë e Eminit tregonin edhe frikë. Ishte e natyrshme, unë isha vëllai i vajzës të cilën ai e kishte vënë në shënjestër e i dërgonte vargje dashurie. Kështu që u nxitova të vija edhe një herë tjetër pikat mbi i. I thashë se unë nuk kisha aspak ndër mend të ndërhyja midis tij e Xhildës e se thjesht doja të dija se çfarë kishte ndër mend të bënte ai.

Emini sikur u qetësua disi, jo shumë, por aq sa të mund të ngrinte kokën e të më shikonte në sy. «Po», tha pastaj. «Nuk i kam shkruar unë. Janë vargjet e një kënge. I ke dëgjuar ndonjëherë 'Magic Friends'?»

Mohova me kokë.

«Nga një këngë e tyrja i kam marrë.» Heshti për një moment. «Dëgjo, Gazi, unë... nuk... ti...»

Zilja e shpëtoi.

«Në ke ndonjë gjë për të bërë, bëje shpejt», i thashë, duke iu drejtuar derës së shkollës. «E mos i bëj keq. Ajo nuk duron dot.»

«Unë... ajo... ajo...»

«Ajo është shumë e bukur», e plotësova unë.

Emini tundi kokën në shenjë miratimi dhe unë kuptova se ajo ditë do të shënohej në kalendar.

Në darkë vërtetova se kisha të drejtë.

Kur u ktheva prej stërviutjes, Xhilda ishte në dhomën e vet.

Duke luajtur me plastelinë.

Hodha çantën e sportin në mes të dhomës sime e u turra jashtë si i tërbuar. Momenti kishte ardhur. Tani mbetej vetëm një gjë për të bërë.

Fatosi ishte në banjë, momentin që për pak sa nuk nxora derën e shtëpisë së tij prej menteshave. Mirë që mamaja e tij ishte vetëm dy hapa larg e ma hapi në kohë.

«Oa të keqen nëna, po ç'ke kështu?»

«Tosi, ku është Tosi? Nënë Alime, ku është Tosi?»

«Është në banjë, por...»

Por unë nuk prita për vazhdimin. E dija – e kisha parë një herë – se sa e shkathët ishte Xhilda në të punuar plastelinën, ndaj dhe duhet të veproja me vrap. Iu turra derës së banjës e fillova t'i bija me forcë.

«Tosi, Tosi, dil shpejt. Shpejt. Tosi...»

«Ej, o Trifi», ma theu Tosi nga brenda. «Prit o se jam pa brekë.»

«Shpejt, shpejt, lëre përgjysmë dhe dil. Shpejt.»

Mamaja e tij kishte mbetur si e shastisur në mes të korridorit e më shikonte e tromaksur.

«Nuk ka ndodhur asgjë, nënë Alimja», i thashë nga frika se mos i binte të fikët. «Thjesht dua t'i tregoj një zog që ka ngecur në dhomën time.»

«Uh, të keqen nëna, se më bëre me zemër. Unë thashë mos kush e di se çfarë.»

Atë çast, Fatosi doli prej banjës.

«Çfarë ke ore? As në banjë s'të le rehat ti», më tha, duke mbërthyer pantallonat.

«Shpejt», i thashë duke i vënë krahun e duke e drejtuar jashtë. «Dua të të them diçka.»

«Ka ndodhur gjë?»

Prita derisa dolëm jashtë dhe Tosi mbylli derën e shtëpisë. Pastaj thashë: «Xhilda. Po tenton përsëri.»

«Nuk të kuptoj.»

«E pashë të luante me plastelinë.»

«Oh, krisht! E të thashë, të thashë t'i thoshe drejt... Idiota, kush e di se ç'i ka thënë!»

«Ti e di se ku e ka shtëpinë?»

«Kush, Emini?»

«Jo po motra ime.»

«Më duket se e ka andej nga ura.»

Këtë e dija edhe unë natyrisht, por doja ta dija me saktësi.

«Në një parafabrikat. Më duket se Edi e di tamam.»

«Je i sigurt?»

«Kështu më tha një ditë.»

«Ikim.» Dhe pa pritur përgjigje u nisa përpara.

«Ej, po prit pak», më thirri Tosi nga pas. «Çfarë ke ndër mend të bësh?»

«Hajde se ta them rrugës.»

Dhe ia thashë... por, natyrisht, vetëm një pjesë ama.

Edin e gjetëm në shtëpi, duke u marrë me detyrat e shtëpisë. Na pyeti se përse nuk ishim edhe ne duke bërë detyrat e shtëpisë dhe unë i thashë një arsye të denjë për kuriozitetin e tij.

«Është për shkak të asaj që ndodhi sot, pas mësimit?» më pyeti pastaj.

Ndala hapat e u ktheva i tëri nga ai. «Pse çfarë ndodhi pas mësimit?»

«Po ja, që ai... propozoi motrën tënde.»

«Xhildën?!» ia bëri Tosi.

«Pse, ka ndonjë motër tjetër Gazi? Nuk e dija unë.»

«Ishe edhe ti me të?» pyeta, por duke e ditur se propozimet nuk bëhen në shoqëri, korrigjova pyetjen. «Domethënë, ty kush ta tha?»

«Emini vetë.»

«E çfarë të tha?» më parapriu Fatosi.

«Më tha që ai i kishte propozuar dhe se ajo i kishte thënë se ai ishte njeri i keq, e se donte vetëm t'i bënte keq e se donte ta rrihte, e ku e di unë, gjëra të këtij lloji. Po...»

«Nejse», e ndërpreva unë. «Se pyesim Eminin, prandaj dhe jemi duke shkuar tek ai.»

Edi nuk u bind edhe aq shumë nga ato fjalë, por pak rëndësi kishte. Na tregoi me saktësi shtëpinë e Eminit dhe roli i tij në këtë histori mbaron me kaq.

Arritëm tek lagjja e Urës në më pak se pesë minuta, gjatë të cilave vrapuam si të marrë në trotuar, në mes të rrugës e mes lulishtes, sikur të na kishte hyrë djalli në bark... uh, më fal! Nuk e kisha me të keq, e kisha vetëm për... nejse.

Emini ishte në shtëpi dhe unë e Fatosi nuk ishim as të fundit e listës së personave që mendonte të takonte atë ditë. Kur më pa, u nxi në fytyrë dhe filloi të dridhej. Por unë nuk e lashë të thoshte as dhe një fjalë, nëse do të kishte mundur të gjente ndonjë fjalë për të thënë.

«Kështu siç je, vish vetëm këpucët dhe eja me ne.»

«Ëh?!»

«E dëgjove», ia bëri Tosi. «Vish këpucët dhe eja.»

«Xhilda është duke qarë. Të kërkon ty.»

Emini u kthye në një statujë e kush e di se për sa kohë do të kishte qëndruar ashtu sikur Tosi të mos e kishte shkundur.

«Ej, djali. Do i veshësh ato këpucët, apo të të tërheqim ne kështu siç je, zbathur.»

Si një robot i komanduar në distancë, Emini ktheu majat nga thembrat e u zhduk brenda shtëpisë.

Fatosi u kthye e më hodhi një vështrim të rreptë.

«Duhet ta bëja», i thashë me zë të ulët. «Po të mos e gënjeja, ai nuk do të vinte.»

Fatosi më tërhoqi larg disa hapa larg derës së apartamentit të Eminin. «Dëgjo një sekondë: ti më the se ke ndër mend të çosh Eminin në shtëpinë tënde, por nuk më ke thënë akoma përse.»

«Që t'i mbush mendjen Xhildës që të mos bëjë... atë që është duke bërë.»

«Ou! Domethënë kështu ti, sa hap e mbyll sytë e fillon e beson se ajo është shtrigë, ëh?»

«Unë nuk e besoj, unë... Unë thjesht kam frikë, Tosi.»

«Frikë? E përse ke frikë?»

«Për Xhildën, Tosi, për Xhildën. Asaj i është mbushur mendja se është një shtrigë dhe kjo gjë është e rrezikshme. Por mbi të gjitha, i është mbushur mendja se njerëzit që kanë një shenjë në vetull, a në ballë, janë të këqij.»

«Këtë e di, o vëlla. I krahason gjithnjë me babanë tuaj, apo jo?»

«Po. E edhe kjo është shumë e keqe. Tani unë nuk mund të them se si është Emini, apo ndonjë tjetër që ka një shenjë në vetull, por dua që motra ime të mos ketë më frikë nga këta lloj njerëzish.»

«E kafshësh», ia priti Tosi.

«O po lëri kafshët, se s'më intereson edhe aq shumë për to, por, ajo që më intereson më shumë është që...»

«Xhilda të mos bëjë magjira ndaj tyre.»

«Të mos gënjejë veten sikur bën», e korrigjova.

«Domethënë të çojmë Eminin e t'i tregojmë se magjia e saj nuk funksionon.»

«Po.»

«Po sikur të funksionojë?»

«Nuk ka për të funksionuar, sepse nuk ka funksionuar kurrë më parë dhe as mos e mendo të më thuash tani të kundërtën, sepse ta kam shpjeguar njëqind herë se si kanë rrjedhur gjërat me të vërtetë.»

Tosi u mat të thoshte diçka, por atë moment u hap dera e apartamentit mbas nesh dhe Emini kapërceu pragun e saj. Sforcimet e tij për të buzëqeshur i shkonin dëm.

Morëm rrugën drejt shtëpisë sime, duke ecur si njerëz normalë: tani që unë isha pranë tij, nuk ishte dhe aq e rëndësishme të vraponim.

«Nuk më besohet», tha në një pikë Emini. «Nuk më besohet që ajo po më kërkon.»

«Do të kishte ardhur vetë», ia prita unë. «Por me mamin në shtëpi, nuk dilte dot.»

Emini sikur s'më dëgjoi. «Pas gjithë atyre që më tha», mërmëriti.

«Pse, çfarë të tha?» dëshirova të dija.

Eminin u kthye nga unë e më pa me habi; nuk e di në ishte se përse unë doja ta dija, apo se përse unë nuk e dija akoma. Sidoqoftë ai zgjodhi të mos thoshte asgjë. Por kurioziteti im donte të kënaqej, ndaj dhe e pyeta në i kishte thënë gjë në lidhje me babin. Babin tonë natyrisht.

Emini u mendua për një çast, gatë të cilit mendova se mos kishte zgjedhur sërish që të heshte, por në të vërtetë, mbas vetëm disa sekondash, foli.

Tha: «Mah, diçka tha, andej nga fundi, kur kishte filluar të bënte hapat e para për t'u larguar prej meje.»

Tosi ktheu kokën nga unë, por nuk ndërhyri.

Unë pyeta: «Çfarë, tekstualisht?»

«Të them të drejtën, as që e mbaj mend mirë. Pas atyre që më tha në fillim...»

«Përse nuk provon t'i thuash që nga fillimi», ndërhyri tani, Tosi.

«Jo», thashë unë. «Ato që i ka thënë ajo, janë punët e tij. E të sajat. Unë dua të di vetëm ato që i ka thënë në lidhje me babin.» Iu ktheva Eminin: «Kështu mund të të jap një mendim, e ndoshta, edhe një shpjegim se përse të kërkon tani.»

«Sinqerisht që nuk e mbaj mend mirë», foli Emini me një zë që të vinte keq ta dëgjoje. Për një moment, u mata t'i thosha se çfarë na kishte thënë Edi, por ndërrova mendje dhe preferova të mos flisja më.

Ecëm kështu edhe për disa minuta, pa shkëmbyer më asnjë fjalë me njëri – tjetrin, derisa Emini u kthye sërish nga unë. Me sa duket gjatë asaj kohe, mendja e tij ishte munduar të kujtonte.

«Nuk e mbaj mend, Gazi, tekstualisht nuk e mbaj mend. Por mund të them se ishte diçka që kishte të bënte me rrahjen... sikur unë do e rrihja, a sikur e doja vetëm për ta rrahur, a diçka e tillë. Pastaj diç më ngatërroi edhe me vetullën: sikur të gjithë fajin e kishte vetulla ime dhe jo unë e sikur të gjithë ne jemi si qeni... a ku e di unë, gjëra të këtij lloji. Prandaj dhe nuk e mbaj mend mirë, sepse nuk mora vesh asgjë.»

Kurse unë kuptoja dhe kuptoja shumë mirë. Besoj se edhe Fatosi kuptonte: tek e fundit ai ishte në dijeni po aq sa edhe unë... ose aty afër.

Vazhduam të ecnim dhe herë pas here i hidhja ndonjë vështrim vjedhurazi Eminin, e ndonjëherë, edhe Tosin matanë tij. Ishte me të vërtetë një situatë të cilën nuk do të arrija ta imagjinoja kurrë se do t'i ndodhte dikujt e aq më tepër mua: një djalë që i kishte

propozuar motrës sime dhe unë që kisha shkuar në shtëpinë e tij dhe e kisha marrë, sepse motra ime (binjake, mbi të gjitha) kishte filluar të qante për të. Në të vërtetë ajo nuk kishte filluar të qante, përkundrazi, megjithatë kjo ishte situata që njihej midis ne të treve dhe ishte krejt absurde. Mendoj se edhe Emini mendonte pak a shumë të njëjtën gjë, sepse ndërsa ecnim, ndieja se edhe ai më hidhte vështrime të shkurtra me bisht të syrit, sikur të donte të zbulonte qëllimet e mia të vërteta, sikur ta ndiente se nuk po shkonim në shtëpinë time për atë që i kisha thënë unë. E duhet thënë se për të dytën e kishte drejt, por sa për të parën, më kot mendohej.

Arritëm përpara pallatit tim. Tosi ndali hapat dhe më thirri mënjanë. Ktheu kurrizin nga Emini, në mënyrë që ai të mos dëgjonte fjalët e tij, ose më saktë, për të mos e lënë të deshifronte lëvizjen e buzëve të tij kur të fliste (duke marrë si bazë faktin që ai dinte të bënte një gjë të tillë).

«Çfarë është?» e pyeta, duke hedhur vështrimin përtej supeve të tij.

«Ti po më fsheh diçka», ia priti Tosi, duke më detyruar të ktheja vështrimin tek sytë e tij. «Nuk e di çfarë, por e di. Prandaj, nëse parandjenja ime është e vërtetë, ma thuaj tani, sa nuk është vonë.»

Arrita vetëm të lëvizja buzët, prej të cilave, pa dyshim, do të kisha nxjerrë gënjeshtren e radhës, kur Emini bërtiti dhe u plas përdhë.

Në të njëjtën kohë Tosi bërtiti: «Ej!» dhe unë thashë: «Oh, t'ëmën!» Pastaj vrapuam drejt tij.

Emini kishte vënë dorën e majtë mbi faqen e majtë dhe me dorën e djathtë shtrëngonte dorën e majtë, sikur të kishte frikë se mos kjo i shkëputej prej faqes, duke ia marrë edhe atë me vete. Në të vërtetë, me dorën e djathtë, Emini mendohej të ndalonte gjakun që i depërtonte përmes gishtave të së majtës.

Me pamjen e gjakut, Tosi ia dha ulërimës me sa kishte fuqi. Pastaj filloi të thërriste: «Ndhmë! Ndhmë!»

Kurse unë iu afrova akoma edhe më Eminin, i cili tani qëndronte shtrirë në njërin anë dhe qante e bërtiste njëkohësisht.

«Shëët», ia bëra, duke i kapur duart e mbushura me gjakun e tij. Ishte gjak i ngrohtë. «Prit të shoh.»

Emini ndaloi së bërtituri, por jo së qari. Më nguli sytë e tij të tmerruar dhe lutje lexova në ta. Pastaj uli vështrimin mbi duart e mia që kontaktonin me duart e tij.

Mbas kurrizit tim, Fatosi, mbasi kishte parë se asnjë nuk po dilte nga asnjë ballkon, apo nga asnjë derë, kishte pushur së kërkuari ndihmë.

Emini la që unë të largoja duart e tij prej faqes së majtë dhe unë i largova ato ngadalë. Ajo që pashë ishte ajo që imagjinoja: dy vrime të vogla, por të thella, rreth një centimetër larg njëra – tjetrës që kullonin gjakun e ngrohtë të Eminin.

«Shpejt», i thirra Fatosit. «Shpejt, ta çojmë lart, sa nuk është vonë.»

«Bir kurve», më shfryu Fatosi, që gjithsesi, u ul të më ndihmonte.

Sapo e ngritëm në këmbë, Emini bërtiti për së dyti herë. Një çast përpara se duart e tij të shkonin mbi plagën e re, pashë dy vrima të tjera, pa aq larg njëra – tjetrës sa edhe dy të parat, të krijojeshin vetvetiu poshtë syrit të tij të djathtë.

«Të thashë», më bërtiti Tosi. «Të thashë se ka për të funksionuar. Gjithmonë i ka funksionuar asaj shtrigës.»

Nuk iu përgjigja. Vazhdova të ngjisja shkallët me shpejtësi, duke tërhequr Eminin mbas vetes. Eminin, të cilit gati sa nuk po i binte të fikët.

Megjithatë, arriti të rezistonte deri në apartamentin e parë të katit të dytë: shtëpinë time.

Dera nuk ishte hapur, por kjo gjë s'përbënte asnjë lloj problemi, duke qenë se kisha në xhep kopjen time të çelësit. Me duart që më dridheshin, arrita të marr çelësin në fund të xhepit, i cili ato momente më ngjatoi me një pus të pafund dhe mu desh ta provoja tri herë, derisa arrita ta fus në bravë.

Në momentin që kapërcyem pragun e derës dhe hymë brenda, Emini bërtiti përsëri dhe unë kuptova se dy vrima të tjera e çanë diku në trup.

Një moment më vonë, motra ime hapi derën e dhomës së saj.

Gjithçka ishte shkruar në sytë dhe mimikën e fytyrës së saj: as që mendohej të *imagjinonte* se mund të shikonte skenën që iu paraqit përpara syve.

Por ajo që doli përpara syve të mi ishte gjithçka që unë kisha imagjinuar gjatë gjithë atyre viteve: motra ime, me fustanin e vjetër të saj që i shkonte deri tek kavaljet, duke i lënë zbuluar këmbët e zbatshur me thonjtë e gishtave të ljer me manikyrin e saj ngjyrë blu; motra ime me buzët e thara prej përpjekjeve dhe përqendrimit, me flokët e shprishur, që i binin mbi supet e lartë e mbi gjoksin e vogël, por gjithsesi, tmerrësisht e bukur; motra ime me kukullën e saj prej plasteline në njërin dorë, ndërkohë që tjetra qëndronte e lirë, gati për t'u ngritur e për të marrë karficën e fundit prej flokëve. Sigurisht, më tepër sesa imagjinuar, unë e kisha parë atë skenë, dikur, kur unë kisha qenë vetëm tetë vjeç dhe kukulla prej plasteline kishte formën e një qeni. Por këtë herë ishte ndryshe, shumë ndryshe.

Unë kisha me vete edhe origjinalin e kukullës... dhe mund të bëhesha dëshmitar i një evenimenti që e kisha pritur prej shumë kohësh. Në qoftë se motra ime do të sillej ashtu siç e kisha menduar të sillej.

Ashtu u soll.

Mbasi qëndroi disa sekonda e habitur tek pragu i dhomës së saj, me kukullën e Eminit prej plasteline në duar (mbi syrin e majtë të të cilit, kishte ngjitur një copë bezeje të bardhë), Xhilda bërtiti. Por nuk ishte tamam një e bërtitur. Mund të them se i ngjante

më shumë hungërimës së një bishe, plot vrer e urrejtje. Dhe e kishte me mua, e kuptova shumë mirë këtë gjë, sepse kur përveshi buzët dhe nxori atë lloj ulërime, sytë e saj të ftohtë ranë mbi mua porsi një pllakë e madhe akulli.

Me shkathtësinë e saj të pashoq, rrëmbeu të fundit karficë të mbetur midis ondeve të verdha dhe e nguli në qafën e kukullës së saj prej plasteline, me aq forcë, sa që nguli në të edhe gishtat e dorës.

Emini bërtiti dhe vetëm një gjysmë sekonde më pas, Fatosi i mbajti ison. Unë ktheva kokën nga ata në kohë për të parë fytyrën e Eminit teksa shpërthente në një shatërvan gjaku, mundimin e kotë të duarve të tij për të frenuar rrjedhën dhe pastaj rrezimin e tij përpara këmbëve të një Tosi, krejtësisht të paralizuar prej terrorit.

Pastaj, Xhilda u vërsul drejt meje. «Pse? Pse e solle këtu, ëh? PSEEEEE?» bërtiste.

U mundua të më qëllonte me Eminin prej plasteline, por unë i bllokova pulsën e dorës. Emini prej plasteline ra në çimento, pranë Eminit prej mishi. Me shpejtësi, vura edhe dorën tjetër tek dora e Xhildës dhe ia spërdrosha mbas shpine, derisa e detyrova të mos bënte më asnjë lëvizje. Afrova gojën time tek veshi i majtë i saj.

«Duhet të shikoja, motërz. Duhet të shikoja me sytë e mi.»

«Nuk duhet ta kishe bërë, *bastard*.»

«Duhet të isha i sigurt»

Nuk e kishte kuptuar akoma. «I sigurt?!» tha. «Për çfarë?»

«Për këtë», ia ktheva dhe e shtyva fort në drejtim të murit.

Nuk pati kohë as të kuptonte se çfarë ndodhi, se i përplasa kokën mbas murit për disa herë me radhë, gjersa i pashë tëmthin e djathtë t'i rridhte gjak të zi dhe i ndjeva trupin të më varej lirshëm në krahë.

E lëshova trupin në çimento dhe u ktheva nga Tosi. Por ai, si shok i mirë që ishte, s'kishte ndër mend të më krijonte as problemin më të vogël: i kishte rënë të fikët.

Trupin e Eminit e lashë në korridor, siç e sheh edhe vetë, kurse dy të tjerët, mbasi i lidha mirë e mirë këmbë e duar, i tërhoqa në dhomën time. Ngrita tapetin dhe bëra vend për vizatimin tim. Prej komodinës nxora shkumësin dhe qirinjtë e mi, si edhe barishtet aromatike që bleva ditën kur Emini i dha Xhildës poezinë e parë.

Vizatova pastaj pentagonin në mes të dhomës dhe sistemova qirinjtë, ashtu siç kisha lexuar në manualin që bleva po atë ditë. E në fund, dogja barishtet dhe thashë formulën me zë të lartë.

Pastaj prita derisa të vije ti.

Ja, tani! Ajo është motra ime. Është një shtrigë dhe ti duhet ta marrësh me vete. Shtrigat nuk duhet të rrinë në këtë botë. Janë të këqija dhe shumë të rrezikshme. Mjafton të dalësh në korridor e të shikosh se çfarë i bëri Eminit të shkretë. Të njëjtën gjë i bëri edhe babit, edhe qenit e të njëjtën gjë i bëri edhe teze Florës, pavarësisht se ishte ajo që e

